



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0796**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa HASANI-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “DIAMANTI” SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “Kuvendi Komunal Lipjan” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush” me numër të prokurimit 613-23-9106-5-2-1, me 12/01/2024, mori:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “DIAMANTI” SH.P.K. me nr. 2023/0796, e datës 16/10/2023, kundër “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” AK, Kuvendi Komunal Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush” me numër të prokurimit 613-23-9106-5-2-1.

2. Mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 05.10.2023, i Autoritetit Kontraktues, Kuvendi Komunal Lipjan, lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit nr; 613-23-9106-5-2-1.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues “DIAMANTI” SH.P.K, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### *Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 30.08.2023, “Kuvendi Komunal Lipjan” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush” me numër të prokurimit 613-23-9106-5-2-1. Ndërsa me datën 05.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 135,000.00 €.

Me 09.10.2023, OE "DIAMANTI" SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "DIAMANTI" SH.P.K me nr. 796/23 lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush" me numër të prokurimit 613-23-9106-5-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraparak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprahe për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "DIAMANTI" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se : "28.092023 kemi pranuar Letrën standarde kërkesë për sqarime shtese për mekanizëm me arsyetimin qe librezat nuk shihen mire, pasë sqarimit nga "DIAMANTI" SHPK ne vend qe te rekomandohemi për kontrate kemi pranuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me dt. 05.10.2023, me arsyetimin se "një ngjarje e paparashikuar ka ndodhur tek përshkrimi i çmimeve dhe nuk mund te evitohet tani ne fazën e vlerësimit". arsyet e AK-së janë vetëm pretekste dhe tendencë për të na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit, gjë qe është bërë pa asnjë bazë ligjore, për arsye se: a ) Për pozicionet 2.1 ne Vrelle dhe Babush te Lipjanit është vendosur sasia totale e gypave ne paramase pa njësi dhe nuk ka te beje me asnjë lëshim ne paramase sepse nuk ka çmime te vendosura nga asnjë OE, gjithashtu pozicioni 42.4 është shume i kjart sepse sasia ne pozicion nuk tregon vendosjen e çmimit por nen pozicionet tregojnë sasinë për vendosjen e çmimeve, prandaj vetëm OE qe nuk janë profesional ne këtë veprimtari e kane te pa kjart këtë pozicion. b) OE qe ka vendosur çmim ne këtë pozicion duhet te shpallet i pa përgjegjshëm e jo te anulohet aktivitetin e prokurimit ne këtë faze sepse pozicioni 4.2.4 është pozicion për një pusët komplet pra vetëm nyja nr. 4 dhe jo pjesët qe do te montohen ne pusët. c) OE DIAMANTI SHPK dhe Infra Plus janë OE te përgjegjshëm për arsye se nuk kanë vendosur çmime ne pozicion 42.4 me qka kane tregu profesionalistet te lart. d)Paramasa dhe para llogaria ka qene e barabarte për te gjitha kompanitë ofertuese, dhe pozicioni 4.2.4 ku ka vendosur çmim OE i tret ne radhe që i njëjti është i papërgjegjshëm nuk e ndikon ne ndryshim ofertës financiare, ku kuptohet qe OE mund te trajtohen ne mënyrë te barabarte. e) Kompania jone duhet te rekomandohet për kontrate sepse kemi ofertuar me çmim më të ulët se sa kompanitë tjera të përgjegjshme. ë ) Neni 62 i LPP-së nuk e parasheh dhe nuk e lejon që një aktivitet i prokurimit të anulohet pas hapjes së ofertave me arsyen që AK-ja ka anuluar, sepse kjo arsye nëse do të ekzistonte do të merrej parasysh para fillimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit. f) Gjithashtu ky anulim është në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast, dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë. Në lidhje me këtë

çështje nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë për rishqyrtim e as një ankesë gjatë fazës së tenderimit, e ku një aktivitet i prokurimit mund të anulohet për kërkesa, specifika apo ndonjë lëshimi në paramasë, kurse edhe ju si AK në momentin e inicimit dhe publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit keni qenë po këta zyrtarë dhe keni pas po këto njohuri që i keni tani dhe me vetëdije të plotë e keni shpallur dhe përgatitur paramasën në këtë mënyrë dhe nëse eventualisht do të kishte ndonjë lëshim atëherë ju do ta kishit vërejtur gjatë fazës së ka qenë i shpallur tenderi, e jo këtë çështje ta theksoni se gjoja e keni kuptuar në momentin pas hapjes së ofertave, e kur janë zbuluar çmimet dhe normalisht kur kuptohet fituesi i këtij tenderi. Po ashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenet 43,5 dhe 43-7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “DIAMANTI” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56.3, 59, 60, 62, 69, dhe 72 të LPP .

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 796/23, ndërsa me datë 27/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0796 me rekomandimet.

Lidhur me pretendimet e OE “DIAMANTI” SH.P.K ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0796 ka vlerësuar si në vijim:

Ekspertes shqyrtuese- “pas analizimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në E-prokurim publikon paramasën lidhur me aktivitetin në fjalë, me date 19.09.2023 I njëjti hap ofertat, tutje gjatë vlerësimit AK me date 28.09.2023 kërkon sqarime nga OE ankuesi lidhur me kërkesat teknike /profesionale, ku OE ankuesi me date 29.09.2023 ka kthyer sqarimet, të cilat AK I merr të mirëqenë. Pastaj, me date 05.10.2023 AK publikon vendimin mbi anulimin me arsyetimin se ka gabime në paramasë, e cila nuk mund të rregullohet në vlerësim. Tutje ekspertja sqaron, në këtë aktivitet janë në proces tre operator ekonomik. Në ofertat e tyre janë të bashkangjitura paramasat, ku dy prej tyre kanë kuptuar paramasën dhe nuk kanë shprehur huti, ndërsa njëri operator ka vendosur çmim në hapësirën ku nuk duhet të vendoset, dhe si e tillë AK/komisioni i vlerësimit ka vërejtur që ky operator ka vendosur çmim në ato pozicione, andaj merr vendim që ta anuloj aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin se nuk mund të rregullohet. Më lartë është e bashkangjitur paramasa e AK-së tek kriteret për vlerësim (pozicionet e pretenduara): Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të paramasës së publikuar nga AK, duke e krahasuar me ofertat e operatorëve ekonomik sqaron se, në këtë aktivitet të prokurimit dy operator kanë kuptuar gabimin e AK-së në paramasë, kurse njëri ka vendosur në pozicionin 4.2.4 çmimin 49 euro, çka do të thotë se dallimi në çmimin përfundimtar të ofertës së tij ndryshon për 49 euro, i cili konsideroj se nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar të ofertave, po ashtu nuk ndikon në ndryshim të radhitjes së operatorëve ekonomik, dhe si e tillë konsideroj se arsyeja e anulimit nuk gjenë mbështetje ligjore sipas nenit 62 të LPP-së si dhe nenit 43.7 të rregullores për prokurim publik. Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit konsideroj se duhet të kthehet në rivlerësim, duke rekomanduar AK-në që procesin e rivlerësimit të zhvilloj konform dispozitave ligjore përkatësisht nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.9 të rregullores për prokurim publik.”

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues Nuk Pajtohet. Ndërsa OE me Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

*- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtraset e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore.

Duke u bazuar në neni 62 të LPP, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, citat “*Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit*”. Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e AK dhe arsyet e anulimit të paraqitura edhe përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim u bind se ky

aktivitet të prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim. Andaj, paneli shqyrtues nuk mund të detyroj AK që të vazhdoj me një aktivitet të prokurimit i cili ka shkelje dhe mund të paraqet vështirësi gjatë realizimit të kontratës. Rrjedhimisht, paneli nuk e mbështet arsyeshmërinë e ekspertizës që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, ngase edhe vet eksperti e evidenton se AK në hartimin e paramasës ka gabime, por sipas ekspertit shqyrtues këto gabime nuk ndikojnë në ndryshim të radhitjes së operatorëve ekonomik. Për panelin shqyrtues nuk është e rëndësishme radhitja e OE, më e rëndësishme duhet të jetë por edhe për ekspertin shqyrtues që përdorimi i fondeve publike të shfrytëzohen drejtë dhe mos ta detyroj AK që të nënshkruaj kontratë për të cilën pastaj mund të ketë pasoja dhe dëmtim të buxhetit dhe mos të arrihet qëllimi i këtij prokurimit i cili do të bie ndesh edhe me nenin 1 i LPP, citat *“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”*.

Kështu që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 të LPP në hartimin e Dosjes së Tenderit dhe nenin 17, konkretisht paragrafin 17.12 dhe 17.15 të rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Lidhur me këto gabime dhe shkeljet të dispozitave ligjore nga ana e zyrtarëve të AK, mban përgjegjësi vetë AK.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar *”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”*.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i papabuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - DIAMANTI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: